



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS  
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

## DEKLARATË PUBLIKE

12 mars 2020  
Prishtinë

*“ Ne jemi aty ku të tjerët nuk do dëshironin të jenë në këto momente”*

*Oda e Mjekëve të Kosovës po përcjell me vëmendje situatën e krijuar pas shpalljes së Coronavirusit Covid-19 si pandemi nga Organizata Botërore e Shëndetësisë, prandaj këtë rast, OMK iu bënë thirrje të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës që t’iu përmbahen udhëzimeve për masat preventive dhe informative të lëshuara vetëm nga Qeveria e Kosovës dhe Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës.*

*Me shpalljen e Covid-19 si pandemi, Oda e Mjekëve të Kosovës poashtu iu bënë thirrje edhe të gjithë komunitetit të profesionistëve shëndetësor, në veçanti anëtarëve të saj, mjekëve të të gjitha fushave për kujdes të shtuar gjatë ushtrimit të profesionit të tyre në këtë gjendje pandemie, meqë janë ata të cilët të parët dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë përballen me pacientët dhe të vetmit që kanë obligim moral, etik dhe profesional të qëndrojnë në ballë në këto rrethana të jashtëzakonshme !*

*Prandaj, OMK kërkon nga të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës që të ruajnë qetësinë dhe ti respektojnë ata dhe të gjitha udhëzimet e dhëna nga profesionistët shëndetësor gjatë marrjes shërbimeve shëndetësore.*

*Mos të harrojmë, profesionistët shëndetësor janë pjesë e kësaj shoqërie që kanë familje njësoj si të gjithë të tjerët, dhe në këtë gjendje pandemie shërbejnë të gjithëve pa dallim dhe me devotshmëri.*

*Andaj, respektojini ata të cilët sakrifikojnë shëndetin dhe jetën e tyre në mbrojtje dhe shpëtim të jetës tuaj!*

*OMK shpreh gatishmërinë e saj për bashkëpunim me secilin institucion të nivelit qendror dhe lokal, si dhe iu bënë lutje anëtarëve të saj që në çdo rrethanë apo situatë me të cilën përballen ta njoftojnë Odën menjëherë!*

*Urojmë që sa më parë të tejkalohet kjo gjendje e jashtëzakonshme!*